



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMET E KURRIKULËS PËR ARSIMIN
PROFESIONAL - TEKNIK (APT)**

**Struktura: Bllok 4 vite
Drejtimi: Veterinari**

FUSHA: SHKENCA SHOQËRORE

LËNDA: HISTORI

**PROGRAMI I LËNDËS
HISTORI
PËR KLASËN E 12-TË**

Koordinatorë: Evis Mastori

Redaktore: Vjola Grillo

Përgjegjëse sektori: Marita Hamza

TIRANË, NËNTOR 2010

Programi “Historia e shqiptarëve” merret me përvojën e jetës njerëzore në të kaluarën. Studimi i saj përfshin hulumtimin e fakteve që hedhin dritë mbi këtë përvojë. Programi i jep mundësi nxënësit të njihet me këtë përvojë, e cila shpeshherë është dhe shfaqet e ndryshme nga e tij, i jep mundësi të marrë më shumë njohuri dhe të kuptojë mënyrat e jetesës, të menduarit etj., dhe, për rrjedhojë, të shohë edhe mënyra të ndryshme të zgjidhjes së problemeve të përsëritura të historisë njerëzore.

Duke njohur përmes fakteve përvojën e kaluar të bashkësisë ku jeton, **nxënësi thellohet në zbulimin dhe në kuptimin e rrënjëve të identitetit të tij dhe të traditave të trashëguara.**

Programi “Historia e shqiptarëve” për klasën e 12-të studion tërë aspektet e jetës shoqërore, si: shteti, ligji, zhvillimi ekonomik, shoqëria, kultura materiale dhe shpirtërore, si dhe veprimtaritë e jetës së përditshme, duke u përpjekur të vendosë një raport të baraspeshuar ndërmjet këtyre fushave të jetës. Përvoja njerëzore, e trajtuar në një kornizë kronologjike e tematike, nuk duhet të paraqitet e kufizuar vetëm në një aspekt të jetës, por të trajtojë probleme që lidhen me qytetërimin, duke filluar nga elementet e jetës së përditshme e deri te sistemet ekonomike, politike e kulturore.

Programi “Historia e shqiptarëve” trajton ngjarjet historike në vazhdimësi kronologjike. Kjo mundëson lidhjen e brendshme e të jashtme midis periudhave dhe shoqërive të ndryshme, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimin botëror. Programi synon që të krijojë te nxënës-i/ja bindjen se qytetërimi i sotëm shqiptar është vazhdimësi progresive e qytetërimit të hershëm, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të. Ruajtja e kronologjisë zbaton kriterin shkencor të zhvillimit të ngjarjeve mbi lidhjen shkak - pasojë dhe vazhdimësinë progresive të rrjedhës historike.

Trajtesa tematike e historisë së shqiptarëve shpreh natyrën përzgjedhëse të programit, i cili nuk ka si qëllim të shtjellojë gjithë ngjarjet e historisë, gjë që do të sillte një ngarkesë të panevojshme për nxënësin, por të trajtojë problemet thelbësore, modelet historike që përbëjnë rrënjët e qytetërimit të sotëm. Trajtesa tematike ka pasur parasysh edhe vendosjen e një baraspeshe historike mes kontributeve të krijuara në periudha të ndryshme në lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve pasardhëse, duke shprehur vlerat e tyre në një këndvështrim të barabartë.

Ky program e ndihmon nxënësin që të kuptojë më mirë realitetin e sotëm dhe ngjarjet aktuale që ndodhin, t’i analizojë ato në mënyrë kritike, duke bërë lidhjen e së sotmes me të shkuarën historike dhe me perspektivat e së ardhmes. Programi shpalos hapësira që i japin mundësi nxënësit për t’u thelluar në fusha të tjera të historisë së shqiptarëve.

Koha dhe ndryshimi - thelbi i historisë

Ndryshimi është aspekti thelbësor i kushteve të njerëzimit dhe, për këtë arsye, është dhe një ndër çështjet themelore të studimit të historisë. Ndërsa lëndë të tjera studiojnë aspekte të ndryshme të jetës së njerëzimit, institucionet dhe traditat kulturore etj., kjo lëndë trajton mënyrën se si të gjitha këto aspekte kanë ndryshuar gjatë historisë së tyre. Ritmet e ndryshimeve historike të aspekteve të ndryshme të jetës dhe të veprimtarisë së njerëzimit janë të ndryshme. Detyra e historianit është të ofrojë një shpjegim të mundshëm për dinamikën e ndryshimit të çdo aspekti. Në këtë mënyrë, **nxënësi do të mësojë për rëndësinë që ka ndryshimi për të gjitha përvojat njerëzore dhe për kompleksitetin dhe mënyrat e ndryshme, në të cilat bashkëveprojnë të gjitha këto përvoja.**

Kuptimi i historisë - rishikimi i historisë

Studimi dhe shkrimi i historisë së çdo vendi është një proces dinamik dhe dialektik si dhe vetë jeta. Kjo do të thotë se faktet dhe kuptimet e reja për to mund të çojnë në rishikimin e shënimeve historike dhe në nevojën për t'u thelluar më tej në kuptimin e historisë. Ky fakt përbën në të njëjtën kohë një mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e mendimit kritik të nxënësit. Të jetuarit në një botë në ndryshim, i jep nxënësit mundësinë të kuptojë dhe të pranojë faktin e thjeshtë se **gjkimi i tij për ngjarjet historike dhe natyrën e tyre, duhet të jetë vazhdimisht objekt rishikimi, analize dhe refleksioni kritik.**

Natyra e lëndës

Parimi që qëndron në themel të këtij programi lëndor, është që studimi i historisë së shqiptarëve duhet të vlerësohet si një eksplorim i asaj çfarë besojnë historianët të ketë ndodhur në të kaluarën dhe sot, duke u bazuar në shqyrtimin e fakteve të vlefshme.

Studimi në thellësi

Programi përfshin studimin e hollësishëm të një numri të caktuar çështjesh historike dhe mundësinë për t'u thelluar më tej në aspekte të përzgjedhura të këtyre çështjeve. Kjo do të krijojë mundësinë për të vlerësuar më shumë kompleksitetin e sfidës së interpretimit të së kaluarës dhe në formulimin e gjykimeve të arsyeshme të bazuara në vlerësimin e fakteve.

Theksi tek aftësitë dhe shprehitë

Studimi i thelluar lehtëson zhvillimin e aftësive historike, në mënyrë të veçantë të aftësisë së punës me fakte dhe të punës kërkimore.

- **Puna me faktet.** Studimi i një prej çështjeve përfshin përdorimin e strukturuar të dokumenteve historike. Kjo ndihmon nxënësit të zhvillojnë përvojën për vlerësimin e fakteve dhe aftësinë për të formuluar gjykime të arsyeshme.
- **Studimi kërkimor.** Përfshirja në kërkim është pjesë përbërëse e programit të historisë. Duke njohur dhe përvetësuar mënyrën se si punojnë historianët, nxënësi zhvillon dhe aftësinë për ta zbatuar atë gjerësisht edhe në fusha të tjera.

1. SYNIMET

1.1. Njohuritë dhe kuptimi i zhvillimit të historisë

Lënda e historisë synon t'i ofrojë nxënësit mundësinë:

- Të zhvillojë njohuritë dhe aftësinë për të kuptuar veprimtarinë njerëzore në të kaluarën;
- të kuptojë të tashmen përmes zhvillimit të këndvështrimit historik për ngjarjet dhe zhvillimet e rëndësishme bashkëkohore;
- të zhvillojë aftësitë e të kuptuarit të historisë së vendit, të Europës dhe të botës;
- të zhvillojë aftësinë e të kuptuarit të koncepteve historike;
- të përvetësojë këndvështrimin e ndryshimit për një realitet në ndryshim.

1.2. Aftësitë

Lënda e historisë synon t'i ofrojë nxënësit mundësinë:

- Të bëhet i vetëdijshëm për interpretimet e ndryshme të çështjeve të veçanta historike;
- të zhvillojë aftësitë bazë të kërkimit historik;
- të vlerësojë natyrën dhe larminë e provave historike.

1.3. Aftësitë qytetare

Lënda e historisë synon t'i ofrojë nxënësit mundësinë:

- Të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik;
- të zhvillojë vlera e qëndrime pozitive lidhur me studimin e historisë;
- të zhvillojë aftësinë për të vlerësuar shoqërinë, në të cilën jeton, dhe të shoqërive të tjera në të kaluarën dhe të tashmen;
- të zhvillojë aftësinë për t'u informuar dhe për të shqyrtuar në mënyrë kritike trashëgiminë e tij historike.

2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

2.1. Njohja dhe kuptimi i ligjësive historike

2.1.1. Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të shpjegojë se si përvojat e paraardhësve kanë ndikuar në botën e pasardhësve;
- të shpjegojë se si historia e Shqipërisë ose e çështjeve të ndryshme të saj, lidhet ose qëndron në kontekstin e historisë rajonale dhe botërore (konteksti ballkanik, europian, botëror, diaspora);
- të shqyrtojë veprimtarinë njerëzore në të kaluarën me larminë e saj, konkretisht në veprimtarinë:
 - ekonomike,
 - shoqërore,
 - politike,
 - administrative,
 - kulturore,
 - shkencore,
 - fetare;
- të shqyrtojë veprimtarinë njerëzore në të kaluarën në këndvështrime të ndryshme, për shembull, në këndvështrimin:
 - gjinor (rol i grave në histori),
 - e rolit të masave,
 - e kufizimeve në kohë dhe në hapësirë të çdo periudhe historike,
 - e vlerave dhe kontributeve në fusha të ndryshme që kanë tejkaluar mundësitë e epokave historike etj.

2.1.2. Nxënësi duhet të jetë i aftë të përdorë konceptet e domosdoshme për studimin dhe shkrimin e historisë, si:

Konceptet procedurale:

- Burime dhe dëshmi.
- Fakte dhe opinione.
- Njëanshmëri dhe objektivitet.

Koncepte të interpretimit:

- Ndryshimi dhe vazhdimësia.
- Shkaku dhe pasoja.
- Krahasimi dhe kundërvënia.

Koncepte të përmbajtjes:

- Pushteti dhe autoriteti.
- Konflikti dhe ripajtimi.
- Demokracia dhe të drejtat e njeriut.
- Kultura dhe qytetërimi.
- Ekonomia dhe shoqëria.
- Identiteti dhe bashkësia.
- Koha dhe hapësira.

2.2. Aftësitë e historianit

Nxënësi duhet të zhvillojë aftësi dhe shprehje që lidhen me studimin dhe shkrimin e historisë.

2.2.1. Njohja dhe pranimi i natyrës së dijes historike

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të pranojë se dija historike është një përpjekje e vazhdueshme dhe jo e dhënë njëherë e përgjithmonë, dhe, për rrjedhojë, objekt i rishikimit dhe i riinterpretimit;
- të pranojë që shkrimi i historisë duhet të bazohet në dëshmi të besueshme, të cilat janë të hapura ndaj interpretimeve të ndryshme dhe të vlefshme.

2.2.2. Aftësitë e kërkimit historik

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përcaktojë një çështje për kërkim studimor;
- të përcaktojë të dhënat historike prej një larmie burimesh parësore dhe dytësore;
- të përzgjedhë dhe të regjistrojë të dhëna që lidhen me çështjen në studim;
- të vlerësojë të dhënat;
- të vendosë të dhënat në tablonë e lidhjeve të përgjithshme kohore dhe hapësinore;
- të paraqesë gjetjet historike në mënyrë të strukturuar dhe logjike.

2.2.3. Aftësia e të punuarit me dëshmitë historike

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të dallojë e të pranojë tipat e ndryshëm të materialeve burimore historike;

- të përfitojë informacion nga materialet burimore për t'i dhënë përgjigje pikëpyetjeve të historisë;
- të vlerësojë dobinë dhe kufizimet e burimeve të veçanta;
- të dallojë njëanshmëritë;
- të dallojë propagandën.

2.2.4. Përgatitja qytetare

Gjatë studimit të historisë, nxënësi duhet të fitojë aftësinë të harmonizojë aftësitë dhe njohuritë historike për të dhënë kontributin e tij vetjak në zhvillimin e personalitetit të tij si individ dhe si qytetar i një bashkësie.

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të gjejë duke u bazuar në vlerësimin e dëshmive;
- të kërkojë dhe të mbledhë informacione nga të gjitha burimet e mundshme dhe t'i regjistrojë ato me kujdes;
- të dallojë dhe të shmangë njëanshmërinë;
- të trajtojë çështjet e diskutueshme dhe kontradiktore nga më shumë se një pikëpamje;
- të vlerësojë trashëgiminë e tij historike përmes studimit të historisë në një larmi këndvështrimesh.

Objektivat e mësipërm duhet të mbahen parasysh nga përdoruesit e programit (autorët e teksteve dhe mësuesit) për të gjitha linjat e nënlinjat që vijnë. Mbajtja parasysh e të gjitha kategorive të objektivave do të mundësojë harmonizimin e kërkesave për përvetësimin e njohurive historike me aftësitë e kërkimit historik e të punuarit me materialet burimore historike dhe me aftësitë e historibërësit, të përshkruara më sipër.

3. LINJAT DHE TEMATIKA

Klasa 12: 36 javë x 2 orë/javë = 72 orë mësimore vjetore

Linjat	Çështjet
Linja I: 5 orë (4+1) Parahistoria (100000 vjet – 3500 vjet më parë)	Temat e linjës: <ol style="list-style-type: none"> 1. Arkeologjia dhe parahistoria shqiptare. 2. Popullsia paleolitike në trojet shqiptare. 3. Qytetërimi neolit. 4. Nga epoka e gurit te metalet. Veprimtari praktike të sugjeruara: <ul style="list-style-type: none"> • Të njohim botën materiale e shpirtërore të protoilirëve. • Parahistoria europiane dhe ajo protoilire (krahasim). • Parahistoria e trevave Adriatiko-mesdhetare.

<p>Linja II: 9 orë (6+3) Qytetërimi ilir mijëvjeçari II- mijëvjeçari I (p.e.r.)</p>	<p>Temat e linjës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Etnogjeneza dhe trojet ilire në Ballkan. 2. Jeta ekonomike e shoqërore e ilirëve. 3. Kolonitë helene dhe ilirët. 4. Shteti i Epirit. 5. Mbretëria Dardane. 6. Roma dhe Iliria. <p>Veprimtari praktike të sugjeruara:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Burimet e shkruara greke e romake për Ilirinë. • Ekskursion në një qytet ilir. • Tezat për pellazgët, ilirët dhe helenët. • A kishin ilirët gjuhën e tyre?
<p>Linja III: 11 orë (7+4) Shqipëria mesjetare (Shek. V - XIV)</p>	<p>Temat e linjës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mesjeta e hershme arbërore (shek. V-X). 2. Arbëria (Shqipëria mesjetare) mes Lindjes dhe Perëndimit (Jeta politike - shek. XI-XIV). 3. Prona feudale dhe jeta qytetare në Arbëri (Shqipëria mesjetare). 4. Organizimi politik në mesjetën e vonë (shek. XIV-XV). 5. Përhapja e krishterimit dhe e organizimit kishtar. 6. Arsimi, arti dhe kultura në Arbëri (Shqipëria mesjetare). 7. Iliria, Arbëria, Shqipëria – vazhdimësi etnokulturore. <p>Veprimtari praktike të sugjeruara:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vëzhgim i një kalaje mesjetare. • Ese: Gjurmë të mesjetës në jetën e sotme. • Jeta mesjetare në folklor, në art etj. • Gjurmë veneciane në Shqipëri. • Gjurmë bizantine në Shqipëri.
<p>Linja IV: 11 orë (7+4) Shqiptarët gjatë sundimit osman Shek. XV – XX)</p>	<p>Temat e linjës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ardhja e osmanëve në Ballkan. Rezistenca ballkano-shqiptare. 2. Besëlidhja shqiptare, formimi i shtetit dhe institucionet e tij. 3. Veprimet luftarake, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe rëndësia e epokës së Skënderbeut. 4. Jeta ekonomike, sociale e kulturore gjatë sundimit osman në Shqipëri. 5. Rezistenca e shqiptarëve, pashallëqet shqiptare. 6. Rilindja Kombëtare: Lufta për tërësinë tokësore dhe autonominë shqiptare.

	<p>7. Përpjekje për gjuhë, arsim e kulturë gjatë Rilindjes Kombëtare.</p> <p>Veprimtari praktike të sugjeruara:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vizitë ose ekskursion në një muze. • Hulumtim: Në gjurmët e toponimisë së periudhës së Skënderbeut. • Studim: Pasqyrimi i figurës së Skënderbeut në artet figurative dhe në letërsi. • Bashkëjetesa fetare gjatë sundimit osman. • Pashallëqet shqiptare në folklorin shqiptar. • Të huajt për Bushatllinj të dhe Ali Pashë Tepelenën. • Të njohim më mirë rilindësit tanë. • Të dimë më shumë për alfabetin tonë.
<p>Linja V: 10 orë (7+3) Shteti i pavarur shqiptar në vitet 1912-1939</p>	<p>Temat e linjës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Luftërat Ballkanike dhe Konferenca e Ambasadorëve në Londër. 2. Shqipëria në Luftën I Botërore dhe Kongresi i Durrësit. 3. Shqiptarët në Kosovë dhe Çamëri gjatë Luftës I Botërore. 4. Çështja shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris dhe Kongresi i Lushnjës. 5. Republika shqiptare në vitet 1925-1928. 6. Monarkia shqiptare në vitet 1928-1939. <p>Veprimtari praktike të sugjeruara:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shqiptarët dhe diaspora në vitet 1925-1939. • Kultura dhe publicistika në vitet 1925-1939. • Italia dhe Austro-Hungaria për shtetin e pavarur shqiptar (studim i dokumentacionit historik të kohës). • Diskutim: Shqipëria politike dhe etnike. • Demagogjia për Shqipërinë e pavarur gjatë Luftës I Botërore. • Rruga e organizimit shtetëror në Shqipëri në vitet 1912-1939 (princni, regjencë, republikë, mbretëri).
<p>Linja VI: 7 orë (5+2) Shqiptarët gjatë Luftës II Botërore 1939-1944)</p>	<p>Temat e linjës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pushtimi italian dhe rezistenca shqiptare në vitet 1939-1943. 2. Pushtimi gjerman dhe rezistenca shqiptare në periudhën shtator 1943 - nëntor 1944. 3. Platformat politike gjatë Luftës II Botërore. 4. Lufta për çlirimin e plotë të vendit në periudhën maj - nëntor 1944. Rezultatet e saj. 5. Kosova e Çamëria gjatë Luftës II Botërore.

	<p>Veprimtari praktike të sugjeruara:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshtypjet e misioneve të huaja për LANÇL. • Forcat politike në Shqipëri gjatë pushtimit dhe roli i tyre. • Qeveritë shqiptare gjatë pushtimit, roli i tyre. • Si duhet t’i nderojmë e t’i vlerësojmë të rënë në luftë?
<p>Linja VII: 9 orë (6+3) Shqipëria gjatë regjimit komunist (1945-1990)</p>	<p>Temat e linjës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vendosija e regjimit komunist. Politika e brendshme e tij në vitet 1945-1990. 2. Krijimi i ekonomisë së centralizuar shtetërore. 3. Politika e jashtme e Shqipërisë në vitet 1945-1990. 4. Arsimi, shkenca, kultura, arti e sporti në vitet 1945-1990. 5. Qëndresa antikomuniste dhe emigracioni politik pas Luftës II Botërore. 6. Kosova dhe shqiptarët në Republikën e Jugosllavinë. <p>Veprimtari praktike të sugjeruara:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lufta e klasave në shoqërinë socialiste. • Përpjekjet për krijimin e “njeriut të ri” në shoqërinë socialiste: dokumente, diskutim, debat. • Të ndërtojmë tërësisht me forcat tona: Utopi, gabim, vetizolim etj. • Shqiptarët në Jugosllavi përballë alternativave të asimilimit dhe afirmimit.
<p>Linja VIII: 10 orë (4+6) Shndërrimet demokratike në Shqipëri gjatë viteve 1990- 2010</p>	<p>Temat e linjës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Lëvizja e dhjetorit e vitit 1990 dhe hapat e parë drejt demokracisë. 2. Vendosija e shtetit të së drejtës dhe e ekonomisë së tregut. 3. Shqipëria në rrugën e integritit euroatlantik në vitet 1990-2010. 4. Sfidat e demokracisë shqiptare. 5. Kosova në vitet 1990-2010. <p>Veprimtari praktike të sugjeruara:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në kuvendin e parë pluralist (partitë, diskutimet e lira, të drejtat dhe detyrat etj.). • Transformimi i jetës në demokraci dhe vështirësitë e saj. • Lëvizja e lirë e njerëzve dhe sot. • Roli i emigracionit në ekonominë shqiptare.

4. KËRKESA TË HISTORISË NDAJ LËNDËVE TË TJERA

HISTORI	MATEMATIKË
Për të gjitha linjat e nënlinjat	Nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none"> Të ndërtojë dhe të interpretojë grafikë, diagrame, tabela statistikore, për paraqitjen e të dhënave historike.
HISTORI	GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
Për të gjitha nënlinjat	Nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none"> Të interpretojë tekste dhe forma të ndryshme të komunikimit, përfshirë ato historike; të shprehë opinione, të arsyetojë, të diskutojë, të argumentojë për çështje që lidhen me tema historike; të shkruajë ese tregimtare, përshkruese dhe argumentuese me tematikë historike; të përzgjedhë informacionin e duhur historik në një vëllim të caktuar; të shfrytëzojë teknikat e duhura gjuhësore, për të shkruar një artikull historik; të shfrytëzojë rregullat e drejtshkrimit për shkrimin e një materiali historik; të lexojë dhe të interpretojë burime të ndryshme historike në dialektet gjuhësore. të shfrytëzojë veprat letrare-artistike si burim informacioni historik. P. sh., të dallojë e të përftojë informacionin historik nga vepra e Barletit për historinë e Skënderbeut; të përdorë folklorin shqiptar si burim historik; të përdorë veprën e rilindësve për të vlerësuar rolin që luajtën ata në historinë e Shqipërisë: “Rilindësit-prodhim i epokës historike shqiptare”.
HISTORI	GJUHË E HUAJ
Për të gjitha nënlinjat	Nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none"> Të shfrytëzojë gjuhën e huaj si burim për interpretimin në gjuhën shqipe të një informacioni historik (p. sh., nxënësit në një veprimtari praktike i kërkohet të gjejë informacion me temë “Perandor romak me origjinë ilire”, duke shfrytëzuar si mjet burimor internetin); të përdorë terminologjinë bazë historike në gjuhë të huaj.
HISTORI	TIK
Për të gjitha nënlinjat	Nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none"> Të shfrytëzojë simbolet për shkrimin e shekujve me shifra romake në kompjuter; të përdorë Word-processor-in për shkrimin e një

	<p>materiali historik;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të përdorë Power Point-in për prezantimin e një detyre në histori; ▪ të ndërtojë tabela, grafikë e diagrame në kompjuter, për të paraqitur me anë të tyre të dhëna të ndryshme historike.
HISTORI	GJEOGRAFI
Për të gjitha nënlinjat	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të shfrytëzojë mjetet mësimore gjeografike, si harta, globi dhe busulla për lokalizimin e territoreve ku kanë zanafillën dhe janë zhvilluar ngjarjet historike; ▪ të lexojë dhe të interpretojë harta të ndryshme historike dhe gjeografike; ▪ të orientohet në hapësirë nëpërmjet hartës dhe globit, për të lokalizuar një territor të caktuar me vlera historike; ▪ të përcaktojë në hartë vendndodhjen e qytetërimeve e të argumentojë rëndësinë e relievit dhe të klimës në zhvillimin e historisë së shqiptarëve; ▪ të përkufizojë dhe të shpjegojë termat "migrim i jashtëm" dhe "migrim i brendshëm" i popullsisë së Shqipërisë, për të treguar lëvizjet e njerëzve dhe pasojat që ato sjellin në periudha e në fusha të ndryshme të historisë.
HISTORI	QYTETARI
Për të gjitha nënlinjat	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të japë një përkufizim të koncepteve: <i>liri, barazi, të drejta, ligj, komb, shtet, etni, demokraci dhe kushtetutë</i>, për të shpjeguar zhvillimin historik të qytetërimit shqiptar gjatë shekujve; ▪ të përshkruajë organizimin e familjes, të institucioneve dhe të shoqërisë, për të përcaktuar tiparet e jetës së përditshme përgjatë periudhave historike; ▪ të përshkruajë format e sistemeve të qeverisjes, për të shpjeguar organizimin shtetëror gjatë periudhave të ndryshme të historisë së shqiptarëve; ▪ të analizojë dhe të interpretojë besimet e ndryshme fetare (politeizmi, monoteizmi, krishterimi, islamizmi) për të shpjeguar rolin e fesë në historinë e shqiptarëve.

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare të lëndës “Historia e shqiptarëve”.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia që të nxënë atë që përshkruhet tek objektivat.

P.sh., le të marrim **objektivin:**

Nxënës/i,-ja duhet të jetë i/e aftë “të ndërtojë linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike”. Ky objektivi do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia të ushtrohen për ndërtimin e linjës së kohës dhe për vendosjen në këtë linjë të periudhave historike. Kjo do të thotë që nxënësit duhet t’i jepet mundësia të përdorë një gjerësi burimesh historike dhe informacioni, si: dokumentet, burimet e shtypura, historinë gojore, median, pikturat, muzetë, galeritë, fotografitë, muzikën dhe internetin si bazë hetimi vetjak, për ndërtimin dhe argumentimin e një ngjarjeje historike.

Orët mësimore

Programi “Historia e shqiptarëve” ka natyrë kronologjike-tematike dhe është strukturuar në linja dhe nënlinja, që vijnë njëra pas tjetrës. Linja nënkupton tematika të gjera historike, ndërsa nënlinjat nënkuptojnë zbrëthimin e këtyre në tema të veçanta.

Programi i lëndës “Historia e shqiptarëve” zhvillohet në **72 orë mësimore vjetore**, prej të cilave: **60-70%** janë **njohuri të reja dhe rreth 40-30% janë në funksion të përpunimit të njohurive**. Këto të fundit mund të jenë veprimtari praktike që i shërbejnë përpunimit të njohurive ose edukimit të aftësive të veçanta që lidhen me studimin e historisë ose të bërjes së saj. Për shembull, në këtë drejtim nxënës/i,-ja mëson si ta vërë veten në pozitën e një historiani, si një eksplorues dhe mbledhës faktesh e dokumentesh, si përzgjedhës, gjurmues (kërkues/hetues), vlerësues dhe parashikues, i aftë për të mbajtur qëndrimin e tij/saj për ngjarje të ndryshme historike, duke u bazuar në burime historike.

Veprimtaritë praktike shërbejnë për t’u ardhur në ndihmë nxënësit dhe mësuesit në orët e përpunimit, me raste sugjerimi për çështje të ndryshme historike, në lidhje me thellimin dhe përpunimin e njohurive dhe të shprehive të fituara në lëndën e historisë, duke e vënë nxënësin në qendër për mbledhjen dhe interpretimin e informacionit.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës. Ata janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shitesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Domethënë, mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të linjës, por mund të ecë më shpejt, kur nxënësit e tij demonstrjnë një përvetësim të kënaqshëm.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive bazë të tij (konceptet themelore);

- testimin e njohurive bazë;
- integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve paraardhës;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (Ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit atyre u duhet kushtuar kohë e posaçme.);
- përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë);
- testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të nisin nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Gjatë përpunimit të njohurive, duhet t'i kushtohet kohë e posaçme veçanërisht kultivimit të:

- Aftësive të përgjithshme, si: aftësia e komunikimit, e menaxhimit të informacionit, e zgjidhjes së problemeve, e të menduarit kritik dhe krijues;
- aftësive të posaçme lëndore, si: forcimi i personalitetit, edukimi i karrierës, aftësia për të vendosur në kohë dhe hapësirë ngjarjet historike, aftësia për të kuptuar, për të analizuar dhe për të argumentuar lidhjet shkak-pasojë, aftësia për të hetuar, për të interpretuar dhe për të parashikuar ngjarje historike, aftësia për të përdorur teknologjinë e informacionit si mjet burimor, aftësia për punë kërkimore, punë në grup etj.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të realizojnë detyra tematike, veprimtari praktike e projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah konceptet dhe të përforcojë shprehitë dhe qëndrimet e nxënësve.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ata objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit janë jo vetëm njohuritë dhe shprehitë, por dhe vlerat e qëndrimet e nxënësve ndaj ngjarjeve ose dukurive të caktuara historike.

Mësuesi i historisë nxit shkallën dhe dinamikën e pjesëmarrjes së nxënësve në procesin mësimor. Ai vlerëson saktësinë e informacionit të paraqitur nga nxënësi, aftësinë e tij për të diskutuar, për të debatuar, për të krahasuar, për të argumentuar dhe për të parashikuar, duke mbajtur qëndrimin e tij personal ndaj një ngjarjeje apo figure të caktuar historike.

Mësuesi i historisë duhet të vlerësojë përdorimin e burimeve alternative nga nxënësit, ballafaqimin e tyre dhe forcën argumentuese ndaj një çështjeje të diskutueshme ose të debatueshme në histori. Kriter vlerësimi për nxënësit në lëndën e historisë është dhe aftësia e nxënësit për të mbajtur një qëndrim të caktuar me argumente dhe për të marrë parasysh argumentet e ndryshme nga të tjerat.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera, si: veprimtari praktike, raste studimore, shkrimi i një eseje, prodhimi i një CD-je, hartimi i një maketi për një ngjarje apo figurë të caktuar historike, projekte etj.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënësi në veçanti.

Mësuesi nuk është i detyruar të vlerësojë me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë, rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe kryerjes mirë të detyrave jashtë klase.

Herë pas here, mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve, që në fillim, qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi e vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet disaminutëshe për një objektivi të veçantë të të nxënësit, tek ato njëorëshe; teste me alternativë ose me zhvillim; detyra tematike, projekte kurrikulare etj. Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare, tabelë kronologjike të ngjarjeve ose të një periudhe historike, CD, dokumentar mbi një ngjarje historike, biografi për histori gojore, postera, albume, ese, artikuj publicistikë etj.

Portofoli i përngjet një albumi, me anën e të cilit mësuesi, nxënësi vetë dhe prindërit e tij gjejnë informacion të shpejtë dhe të sintetizuar rreth progresit të nxënësit. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, ndërsa mësuesi rekomandon.

Çrregullime të diagnostikuara, si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh., të fëmijëve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren parasysh nga mësuesi, duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme.